


# Raport Paraprak

## Vleresim i Ndikimit ne Mjedis

I projektit "Ndertim dhe Shfrytezim i  
Depozitave Bregdetare per Nafte" nga B-  
Jera sha  
Porto Romano

Durres



**Administrator: Shoqeria "B-Jera" sha**

**Pergatitur nga: "Green Hours" shpk**

**Tirane, me 18.08.2017**

## **Pasqyra e lendes**

### **I. Hyrje**

### **II. Baza Ligjore**

### **III. Te dhenat mbi subjektin**

### **IV. Te dhena mbi aktivitetin**

- 1. Histori e shkurter e aktivitetit*
- 2. Kapacitetet perpunuese*
- 3. Vendndodhja e objektit*
- 4. Madhesia e objektit*
- 5. Punesimi*

### **V. Kushtet gjeomjedisore te zones se implementimit te projektit**

- 1. Topografia dhe batimetria*
- 2. Situata gjeologjike*
- 3. Kushtet klimatike*
- 4. Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi*
- 5. Informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij*
- 6. Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër*
- 7. Informacion për kohezgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar*
- 8. Një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve*
- 9. Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të*
- 10. Mbi mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përfaqësuara për rehabilitimin*
- 11. Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis*
  - 11.1 Plani i menaxhimit të mjedisit*

*11.2 Monitorimi i përgjithshëm mjedisor, monitorimi mbi përmbushjen e detyrimeve sociale dhe raportimi*

*11.3 Reabilitimi dhe parandalimi i ngjarjeve të jashtëzakone*

*11.4 Permbledhje e masave zbutëse*

*12. Zbatimi i planit të menaxhimit*

**VI. Per monitorimin e vazhdueshem të ndotjeve**

**VII. Plani i Veprimit Mjedisor**

**VIII. Plani i emergjences**

**IX. Menaxhimi i Incidenteve**

**X. Perfundime**

## Hyrje

Studio e konsulences “Green Hours” shpk eshte studio e paisur me Licence LN-7408-02-2014 per hartimin e raporteve te vleresimit te ndikimit ne mjedis, per te kryer auditim mjedisor, per hartimin e ekspertizave per probleme mjedisore dhe thirjen si ekspert per te vleresuar nje raport te vleresimit te ndikimit ne mjedis ose rezultatet e nje auditimi.

“Green Hours” shpk eshte e certifikuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave sipas Vendimit Nr 3, Nr 197 regjistri, Nr 324 prot, date 20.04.2006.

Prane studios “Grren Hours” shpk punon si drejtues teknik eksperti mjedisor Denis Harasani i paisur me Certifikate nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave me Nr 5116 Prot, Nr identifikues 143, date 08.07.2013 dhe z. Miltiadh Mata

“Green Hours” shpk eshte e regjistruar ne QKR dhe eshte e paisur me NIPT K61626009I

Gjate periudhes Gusht 2017 me kerkese te “B-Jera” sha, u realizua procesi i Vleresimit Paraprak te Ndikimit ne Mjedis i aktivitetit te ndertimit dhe shfrytezimit te “Terminalit te depozitimit te karburanteve” B-Jera sha, Porto Romano, Durres.

***Theksojme se Raporti i VNM-se Paraprake per kete aktivitet eshte miratuar nga AKM me Vendimin Nr 30, Nr Identifikimi 538, date 24.07.2017 dhe riparqitet per shkak te shteses ne projekt te dy depozitave me kapacitet 1465 m<sup>3</sup> secila, per depozitim dhe tregtim te biodiezelit.***

Shoqeria “B-Jera” sha, ndermjet te tjerave, synon te ushtroje veprimtarine ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fushen e mbrojtjes se mjedisit. Per kete arsye, stafi drejtues eshte i impenjuar ne procesin e realizimit dhe krijimit te kushteve per Vlerimin e Ndikimit ne Mjedis dhe te pergatitjes se dokumentacionit te plote per paisjen me Leje Mjedisore.

Bazuar ne legjislacionin per mjedisin, duke i u referuar projektit per investimin qe do te kryej, kapaciteteve perpunuese te terminalit etj, mendojme qe subjekti permbush kriteret per realizimin e Studimit Paraprak te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis.

Procesi i Vleresimit Paraprak te Ndikimit ne Mjedis u realizua sipas hapave te me poshteme:

- Njohja me subjektin qe ushtron aktivitetin
- Njohja me objektin ku zhvillohet aktiviteti
- Njohja me problematiken e pergjitheshme dhe natyren e aktivitetit

- Njohje me linjat kryesore teknologjike.
- Njohje me produktin
- Identifikimi i lendeve te para.
- Identifikimi i lendeve ndihmese te perdorura ne procesin e ndertimit dhe shfrytezimit
- Identifikimi i mbetjeve dhe shkarkimeve te ndara sipas natyres
  - a. Mbetje te ngurta
  - b. Shkarkime ne ajer
  - c. Shkarkime ne uje
- Njohje me masat e mara per trajtimin e mbetjeve
- Identifikimi i mundesive per minimizimin e ndikimit

Rezultatet e ketij vleresimi paraqiten ne kete raport me qellimin final:

- Vleresimin e bilancit te shkarkimeve ne ajer.
- Identifikimin e shkarkimeve ne ujrat siperfaqesore dhe nentokesore
- Trajtimin mjedisor te mbetjeve te ngurta
- Hartimin e programit te monitorimit
- Perfundime.

## **II. Baza Ligjore**

Per hartimin e studimit Vleresim i Ndikimit ne Mjedis i aktivitetit te ndertimit dhe shfrytezimit te “Terminalit te depozitimit te karburanteve” B-Jera sha, Porto Romano, Durres, jemi mbeshtetur ne bazen ligjore te meposhteme:

### **1. Legjislacioni shqiptar**

#### **Ligji per Mbrojtjen e Mjedisit**

Parimet kryesore, te cilat rregullojne legjislacionin mjedisor ne Shqiperi, jane te njejta me ato te Bashkimit European. Ato jane te percaktuara ne ligjin e ri per Mbrojtjen e Mjedisit nr. 10 431, datë 9.6.2011, kapitulli II:

Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të projektit, me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative në mjedis, përmes harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit.

### **Ligji per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis**

Ligji i VNM nr. 10440 dt. 07/07/2011 eshte nje nga aktet ligjore me te rendesishem per parandalimin e ndotjes apo demtimit te mjedisit nga aktivitet humane. Ky ligj kerkon berjen e nje vleresimi te pergjithshem, te integruar dhe ne kohe te ndikimeve mjedisore, te projekteve ose veprimtarive qe kerkojne te zbatohen, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative ne mjedis.

### **Ligji per Planifikimin e Territorit**

Ky akt ligjor me nr. 10119, datë 23.4.2009, azhornuar ne vitin 2010, ka për objekt përcaktimin e parimeve bazë, përgjegjësi, rregullave dhe procedurave për planifikimin e territorit. Ligji, nder te tjera ka per qellim:

- të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore;
- të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillim të territorit në nivel kombëtar e vendor, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publike e privatë, duke bashkërenduar:
- mbrojtjen e burimeve natyrore, si: toka, në veçanti toka bujqësore, ajri, uji, pyjet, flora, fauna, peizazhet;
- të garantojë, sipas legjislacionit për ndërtimin, zbatimin e rregullave të sigurisë së ndërtimeve dhe të punimeve të ndërtimit për jetën dhe shëndetin e njerëzve.
- të nxisë veprimtarite e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike dhe të peizazhit;

### **Ligji per Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore**

Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e njësi të qeverisjes vendore si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre dhe të organeve përkatëse. Ne nene te vecanta te ketij ligji, Keshillat Bashkiake ushtrojne te drejta dhe kompetencat e tyre te plota, nder te tjera edhe per:

- planifikimin urban, menaxhimin e tokës dhe strehimin, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
- mbrojtjen e mjedisit;
- administrimin e parqeve, lulishteve dhe zonave të gjelbëra publike;
- grumbullimin, largimin dhe përpunimin e mbeturinave.
- furnizimin me ujë të pijshëm;
- funksionimin e sistemit të kanalizimeve të ujërave të bardha, të ujërave të zeza dhe të kanaleve mbrojtëse të zonave të banuara;
- funksionimin e transportit publik urban;
- ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave kulturore dhe historike vendore.

Krahas ligjeve te cituara me siper mbrojtja e mjedisit rregullohet dhe nga aktet ligjore te meposhteme:

- “Per Vleresimin Strategjik Mjedisor”;
- “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve;
- “Per mbrojtjen e biodiversitetit”;
- “Per trajtimin e ujrave te ndotur”;
- “Per substancat dhe preparatet kimike”;
- “Per administrimin e zhurmave ne mjedis”;
- “Per zonat e mbrojtura”;
- “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”;
- “Per taksen e karbonit e te ambalazhit plastik”;
- 

Per zbatimin praktik te ligjeve te sipercituar jane ne fuqi nje sere VKM dhe Udhezime, nder te cilat nga me kryesoret jane:

- Vendimi “Per monitorimin e mjedisit ne Republiken e Shqiperise”;
- Vendimi “Per normat e cilesise se ajrit”;
- Vendimi “Per normat e shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit”;
- Vendimi “Per shpalljen e monumenteve te natyres shqiptare”;
- Vendimi “Per administrimin e zonave te mbrojtura”;
- Vendimi “Per miratimin e katalogut shqiptar te klasifikimit te mbetjeve”;
- Udhezimi “Per dokumentacionin e domosdoshem per te kerkuar Leje Mjedisore”.

### **Legjislacioni kryesor shqiptar per perpunimin, depozitimin dhe transportimin e naftes, gazit e nenprodukteve te tyre**

Referuar praktikave procedurjale, ne zbatim te politikave te shtetit shqiptar, realizimi i nje projekti, krahas pajtushmerise me legjislacionin ne fushen e mbrojtjes se jetes se njeriut dhe mjedisit, duhet te bazohet ne legjislacionin e fushes se aktivitetit perkates nepermjet te cilit percaktohen te drejtat dhe detyrimet per kryrjen e ketij aktiviteti.

Konkretisht per te gjitha projektet qe i perkasin fushes se perpunimit, transportit, depozitimit dhe tregetimit te naftes dhe nenprodukteve te saj eshte hartuar nje kuader i tere ligjesh dhe VKM-she, nga te cilet disa nga me kryesoret jane:

Ligji 8450, date 24.02.1999 “Per Perpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregetimin e naftes gazit dhe nenprodukteve te tyre.” i ripunuar

VKM 358, date 27.05.2001 “Per procedurat dhe kushtet per dhenien e lejeve per ndertimin dhe perdorimin e instalimeve bregdetare per transportimin dhe depozitimin e naftes gazit dhe nenprodukteve te tyre.”

VKM 703, date 23.04.2008 “Per miratimin e studimit Zhvillimi i integruar ne sinergji i zones energjitike dhe industriale Portoromano Durres, infrastruktura dhe konturet e saj.”

Udhezimi Nr.1 date 30.04.2012 “Rregullat dhe procedurat e shqyrtimit te aplikimeve per marrjen e Lejeve Ndertimore per objekte te natyres energjitike dhe objekte me rrezikshmeri te larte te kesaj fushe si dhe per ngritjen e komisionit per shqyrtimin e kerkesave per dhenien e ketyre Lejeve”

## **2. Legjislacioni nderkombetar**

- KONVENTA E BERNES “Per ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror ne Europe”. Ratifikuar me Ligjin Nr. 8294, date 02.03.1998;
- KONVENTA E BARCELONES “Per mbrojtjen e mjedisit detar dhe te zones bregdetare te Detit Mesdhe” dhe protokollet e saj. Ratifikuar me Ligjin Nr 8690, date 16.11.2000;
- KONVENTA E BONIT “Per mbrojtjen e llojeve shtegetuese te kafsheve te egra” dhe mirëkuptimet e saj . Ratifikuar me Ligjin Nr.8692, date 16.11.2000;
- KONVENTA E BAZELIT “Per kontrollin e levizjeve ndekufitare te mbetjeve te rrezikshme dhe asgjesimin e tyre”. Ratifikuar me Ligjin Nr. 8216, date 13.04.1997;
- KONVENTA E VIENES “Per mbrojtjen e shteses se ozonit” dhe PROTOKOLLI I MONTREALIT “Per substancat qe hollojne shtesen e ozonit”. Ratifikuar me Ligjin Nr.8463, date 10.03.1999;
- KONVENTA E AARHUS : “Mbi te drejten e publikut per te pasur informacion ,per te marre pjese ne vendim-marrje dhe per t’iu drejtuar gjykatesper ceshtjet e mjedisit”. Ratifikuar me Ligjin Nr.8672, date 26.10.2000;
- KONVENTA E ESPOO-S “Mbi vleresimin e ndikimit ne mjedis ne kontekst nderkufitar “. Aderuar me 4 Tetor 1991;
- KONVENTA KUADER E KOMBEVE TE BASHKUARA PER NDRYSHIMET KLIMATIKE, Tetor 1994;
- KONVENTA E KOMBEVE TE BASHKUARA PER BIODIVERSITETIN, Janar 1994;

## **III. Te dhenat mbi subjektin**

“B-Jera” sha”, eshte shoqeri e specializuar per:

- Tregtim me shumice i naftes, gazit, nenprodukteve, perfshire ato bio, si dhe lende djegese, duke perfshire gjithashtu si me poshte vijon:



- tregtim me shumice i naftes bruto e nenprodukteve te saj te kategorive 0, II, III, IV e V, me perjashtim te nenprodukteve qe destinohen per furnizimin e mjeteve te fluturimit ajror;
- tregtim me shumice i gazit te lengshem te naftes, kategoria I, perfshire edhe mbushjen e bombolave me kete nenprodukt;
- tregtim me shumice i karburanteve, kategorite II/B e III/C, per mjetet e fluturimit. Import eksport tregti me shumice e pakice te karburanteve, lubrifikanteve, vajrave, graso, gaz e lende djegese te te gjitha llojeve dhe kategorive;
- Prodhim, eksport-import, tregtim te materialeve te ndertimit, si dhe te materialeve qe perdoren per industrine e naftes, gazit, ujit dhe minierave;
- Ushtrimin e tregtise me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industriale, pajisje e materiale te ndryshme hidraulike dhe elektrike dhe ne pergjithesi cdo aktivitet plotesues;
- Import dhe eksport mallra e pajisje te te gjitha llojeve, makineri e pajisje si dhe aktivitetin e shperndarjes dhe perdorimit te tyre, per vete shoqerine dhe per te tjere;
- Te kryeje furnizime te impianteve dhe pajisjeve teknike per aktivitetet qe operojne dhe qe kane lidhje me asetet e shoqerise;
- Shoqeria mund te kryeje te gjitha operacionet industriale, tregtare, prodhuese, ndertuese, ndertime te objekteve te ndryshme industriale e civile, prodhim te inerteve dhe materiale ndertimi, financime qe konsiderohen te nevojshme per arritjen e qellimit te shoqerise si dhe cdo veprimtari tjeter qe nuk bie ne kundershtrim me ligjin;
- Shoqeria do te kryeje veprimtari ne fushen e hotelerise, turizmit, ushqimit, administrimit, te internetkafese, perfshire administrimin e aktiviteteve te lidhura me te si bar-kafe dhe sherbime si fotokopje, shitje te vogla kancelarie dhe materiale te konsumit te aktiviteteve te tjera te ketij lloji. Te hyje ne veprimtari tregtare qe arrijne ne realizimin e qellimit te saj tregtar;
- Shoqeria mund te kryeje drejtperdrejt apo indirekt, brenda dispozitave ligjore, pjesemarrje ne shoqeri te tjera te zhvilloje cdo lloj aktiviteti qe lidhet dhe ne menyre indirekte me qellimet e shoqerise e qe vleresohen te dobishme per arritjen e tyre;
- Te importoje, eksportoje dhe tregtoje makineri dhe pajisje e produkte te ndryshme te te gjitha llojeve. Te ofroje dhe te kryeje sherbime e konsulenca ne fushen teknike dhe tregtare. Te organizoje kurse formimi dhe specializim.

Shoqeria eshte person juridik, me perfaqesues ligjor zotin Klej Jera .

Shoqeria “B-Jera” sha eshte e regjistruar ne date 17.02.2017 ne Regjistrin Tregtar, prane Qendres Kombetare te Regjistrimit

Shoqeria eshte e paisur me Certifikaten e Rregjistrimit te Personit te Tatushem me numer kod NIPT-i L71417501R

Adresa e shoqerise eshte Rr. “Parku energjistik”, Porto Romano, Durres.

## **IV. Te dhena mbi aktivitetin**

### ***1. Histori e shkurter e aktivitetit***

“B-Jera” sha aktualisht ka aplikuar ne institucionet pergjegjese te shtetit shqiptar per ndertimin dhe shfrytezimin e nje terminali per depozitimin e karburanteve ne Porto Romano, Durres, ne zonen ku shtrihet Parku Industrial dhe Energjetik i Portoromanos

Qellimi i ketij inverstimi eshte:

- Pritja e produkteve te naftes qe vijne ne rruge tokesore me autocisterna dhe ate detare me anije te tipit cistern.
- ruajtja e tyre ne rezervuaret perkates
- mbushja e autocisternave dhe shperndarja e tyre ne destinacion.

Ne kete kuader kjo shoqeri eshte duke pergatitur dokumentacionin e nevojshem per vazhdimin e procedurave per realizimie ketij projekti, ne zbatim te legjislacionit ne fuqi.

### ***2. Kapacitetet perpunuese***

Terminali i depozitimit te karburanteve do te ndertohet ne brendesi te Parkut Energjistik dhe Industrial te Portoromanos.

Nyja teknologjike do te kete nje siperfaqe rreth 20000 m<sup>2</sup>. Kapaciteti total i depozitimit eshte 79.200 m<sup>3</sup>.

### ***3. Vendndodhja e objektit***

Objekti “Terminali i depozitimit te karburanteve” ngrihet ne nje zone te ndodhur ne Porto Romano, Njesia administrative Katund i Ri-Durres. Ajo ndodhet ne veriperendim te qytetit te Durresit dhe ne nje distance rreth 6 kilometra ne vije ajrore larg prej tij. Sheshi ku ngrihet objekti ze nje siperfaqe prej 20.000 m<sup>2</sup> dhe ndodhet brenda njerit nga kuadratet e miratuar me V.K.M., Nr 251, dt. 25.04.2001.

Ky objekt eshte parashikuar per tu ndertuar ne truallin prone e shoqerise me nr pasurie 64/120 me nje siperfaqe prej 20.000 m<sup>2</sup>, zk 3184, Durres, ne krah te djathte te rruges kryesore Porto Romano – Bishti i Palles. Ne kete baze do te depozitohen per tu ruajtur dhe shperndare dy nenprodukte te naftes: benzine dhe gazoil.

Koordinatat simbas sistemit Gaus-Kruger te siperfaques ku do te ndertohet terminali jane si me poshte:

**Pika A ne qender te sheshit**

Sistemet koordinative	Easting	Northing
ETRS89	19° 25' 40.3392"	41° 23' 3.7684"
UTM Zone 34N	368550.62	4582620.73
Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4	4368628.50	4584585.81
KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator	452144.54	4583419.59

**Pika B ne skajin Veri-Perendimor te sheshit**

Sistemet koordinative	Easting	Northing
ETRS89	19° 25' 35.3567"	41° 23' 3.8118"
UTM Zone 34N	368434.92	4582624.17
Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4	4368512.75	4584589.25
KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator	452028.78	4583421.70

**Pika C ne skajin Veri-Lindor te sheshit**

Sistemet koordinative	Easting	Northing
ETRS89	19° 25' 42.6953"	41° 23' 6.5938"
UTM Zone 34N	368606.93	4582706.88
Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4	4368684.82	4584671.99
KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator	452199.85	4583506.40

**Pika D ne skajin Jug-Perendimor te sheshit**

Sistemet koordinative	Easting	Northing
ETRS89	19° 25' 37.7514"	41° 23' 0.3923"
UTM Zone 34N	368488.63	4582517.71
Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4	4368566.48	4584482.74
KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator	452083.72	4583315.84

**Pika E ne skajin Jug-Lindor te sheshit**

Sistemet koordinative	Easting	Northing
ETRS89	19° 25' 45.5534"	41° 23' 3.4061"
UTM Zone 34N	368671.53	4582607.37
Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4	4368749.45	4584572.44
KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator	452265.61	4583407.62



Teritori ku parashikohet te ndertohej terminali me te gjithë elementet teknik është mjaft i pershtatshem per funksionimin e ketij aktiviteti pasi paraqet nje sere perparimesh si:

- Shtrirja ne brendesi te parkut energjistik te Portoromanos..
- Sistem te siguruar te furnizimit me uje
- Sistem perspektiv te furnizimit me energji elektrike.
- Mundesi per zbatimin korekt te procesit teknologjik
- Mundesi per ngritje te sistemit te kanalizimeve dhe shkarkimeve.

Pozicioni i terminalit te depozitave ka te zgjidhura disa nga problemet me te rendesishme ne lidhje me anen funksionale si:

Largesi te mjaftushme nga vendet e banuara.

Prane fuqise punetore.

Brenda nje teritori te studiuar nga ana urbanistike.

Prane rruges nacionale.

Larg zonave te mbrojtura, arkeologjike, shkollave, kopshteve, spitaleve etj.



Pamje e pjeseshme nga infrastruktura rrugore aktuale ne Parkun Industrial dhe Energjetik te Potoromanos e ndertuar nga shoqerite qe kane depozita bregdetare ne kete zone



Pamje e gjeomjedisit dhe ekosistemit continental te zones ku do te ndertohej terminali

#### ***4. Madhesia e objektit***

Sic e kemi permendur objekti i terminalit te depozitave do te kete nje siperfaqe rreth 20000 m<sup>2</sup>.

#### ***5. Punesimi***

Gjate procesit te ndertimit te terminalit do te punesohen rreth 50 punetore dhe gjate procesit te shfrytezimit do te punojne 20 punonjes te perhershem.

Nga pikpamja sociale, zhvillimi i ketij aktiviteti eshte faktor per zbutjen e papunesise dhe burim te ardhurash per familjet qe jetojne duke punuar ne kete shoqeri.

### **V. Kushtet gjeomjedisore te zones se implementimit te projektit**

#### ***1. Topografia dhe batimetria***

Rajoni i Durrësit ofron pamje të përgjithshme fushoro – kodrinore , ku vecohen : sistemi kodrinor – i urbanizuar kryesisht me ndërtime të ulta dhe ai fushor në lindje e jug të tij , ku kohët e fundit ndërtimet i janë drejtuar lartësive të mbi 10 kateve. Ne rastin konkret kemi te bejme me nje terren fushor gjysem mocalor i bonifikuar nga nderhyrja e dores se njeriut por qe ende ne pozicione te caktuara ruan nje kuote deri 1 meter nen nivelin e detit. Sistemi kodrinor ngushtohet drejt veriut dhe ndërpritet në zonën e P. Romanos (hidrovori) për t'u ringritur përsëri pas rreth 2 km. në kodrat e K.Pallës, duke formuar kështu një gji detar relativisht të cektë. Komunikimi i dikurshëm det – lagunë, u ndërpre pas viteve 60' , nga veprat bonifikuese dhe sistemi i zonës fushore të ish kënetës Durrësit, nëpërmjet digës mbrojtëse të lartë 2.0 m që përbën aktualisht edhe trasenë e vetme të rrugës për në K.Pallës. Karakteri mocalor dhe me ndotje te shumta siperfaqesore dallohet qarte dhe ne fotot e meposhteme te cilat jane dhe pasqyre e gjeomjedisit toksor i cili perfshihet ne teritorin e Parkut Energjetik dhe Industrial te zones se Portoromanos

Sikurse e permendem dhe me siper, terreni ne te cilin realizohet ky projekt eshte fushor i perbere kryesisht nga depozitime te shkriфта si rera, surera, suargjila, depozitime llumore etj. Ky terren fushor ne kushte normale mbulohet nga nje vegjetacion tipik te zonave gjysem mocalore.

Ne te djathte te teritorit te paraqitur zhvillohet emisari perendimor i drenimit te ujrave siperfaqesor te ish kenetes se Durresit dhe qe shkarkon ne emisarin qendror grykderdhja e te cilit eshte vet hidrovori i zones se Portoromano. Sikurse e kemi permendur dhe ne studime te tjera kjo zone litorale e ketij brgdeti ngelet nga me te kontaminuarat pasi nepermjet ujrave siperfaqesor ajo mbledh nje pjese te toksikacioneve qe kane mbartur zonat me ndotje te rrezikeshme industriale si ish Uzina Kimike apo ish depot e pesticideve.

## ***2. Situata gjeologjike***

Terreni ne te cilin do te implementohet ky projekt i perket depresionit te Durresit qe shtrihet midis kodrave te Bishtit te Palles dhe atyre te Ishmit, ndersa nga pikpamja gjeomorfologjise siperfaqesore kemi te bejme me nje gjeosinklinal me amplitude te vogel e cila Brenda kontureve te ish kenetes se Durresit varjon me nje amplitude rreth 1,5 meter nga qendra ne periferi. Nga pikpamja Litologjike zona ku perfshihet ky shesh (kuadrati qe do ti vihet ne dispozicion kesaj shoqerie) perfaqesohet nga nderthurje argjilore dhe ranore me strukture te ndryshueshme si ne aspektin granulometrik po ashtu dhe ate litologjik.

Konkretishte referuar kampjonatures se studjuar ne kete zone kemi keto variacione te priteshme litologjike per kete shesh ndertimi. Trashesia siperfaqesore nga 0 deri ne 1,5 m perfaqesohet nga dhera te kuaternarit me dominim te humusit, argjilave te treteshme



dimra të ftohtë temperaturat zbresin deri në  $-7^{\circ}\text{C}$  dhe  $-9^{\circ}\text{C}$  dhe në raste shumë të rralla deri edhe në  $-13^{\circ}\text{C}$ . Periudha me ngrica është e shkurtër. Zakonisht vrojtohen 15-30 ditë në vit. Ditët e akullta duken nga fundi i Nëntorit dhe mund të vrojtohen deri në fund të Marsit por përgjithësisht ato vrojtohen gjatë Janarit dhe Shkurtit.

Periudha e vegjetacionit (temperatura  $\geq 10^{\circ}\text{C}$ ) fillon mesatarisht në dekadën e parë të muajit Mars dhe vazhdon deri në fillimin e decades së parë të muajit Dhjetor. Afërsia me detin bënë që në pranverë ngrohja të jetë e ngadaltë. Periudha e nevojshme për të kaluar nga temperatura  $7^{\circ}\text{C}$  në  $10^{\circ}\text{C}$  zgjat 30-40 ditë. Era fryn përgjithësisht në dy drejtime. Gjatë gjysmës së ftohtë mbizotëron juglindja ,pa përjashtuar veriun. Në gjysmën e ngrohtë mbizotëron veriperëndimi, që përputhet edhe me qarkullimi brizor të kësaj periudhe. Shpejtësitë e erës në këtë zone janë ndër më të mëdhatë që vrojtohen në vendin tone.

#### ***4. Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi***

Perpara viteve 90 ne kete zone zhvillohej aktivitet bujqesor. Vitet e fundit ne kete zone (zone kenetore) eshte vendosur Parku Energjitik i Portoromanos.

Bimesia ne kete zone eshte ajo tipike e zonave bregdetare. Ne rajonet perendimore dhe bregdetare mbizoterojne llojet mesdhetare te bimesise si shkurret me gjelberim te perhershem (makiet) nder te cilat: mareja, shqopa, xina, gjineshtra, dafina etj. Se bashku me keto shkurre rriten edhe disa drure te larte, si: selvia, valanidhi, pisha e bute dhe e eger etj. Pjesen e siperme te brezit te shkurreve mesdhetare e zene shkurret qe i rrezojne gjethet gjate stines se dimrit, si: shkoza e bardhe dhe e zeze etj.



Gjithashtu jane te shumta bimet endemike, pra bimet qe rriten vetem ne trevat shqiptare. Vetem ne Republiken e Shqiperise rriten rreth 30 te tilla.





Bimesia e kultivuar perfaqesohet nga dritherat, perimet, foragjeret.

Nder pemet frutore ne kete zone kultivohet pjeshja, kumbulla, hurma, ulliri, vreshtat etj.

### ***Zonat e mbrojtura***

Ne Shqiperi, Zonat e Mbrojtura jane te konsideruara si pjese /siperfaqe e tokes dhe/ose ujit, detare/bregdetare, te destinuara kryesisht per konservimin e biodiversitetit, burimeve natyrore dhe kulturore qe shoqerojne atë/ato dhe qe jane te menaxhuara ne menyre te ligjshme dhe/ose ne menyra te tjera efektive.

Rrjeti i zonave te mbrojtura eshte bazuar ne kategorite e menaxhimit te IUCN dhe sistemi i ndertuar per kete qellim eshte ne perputhje me sistemin nderkombetar IUCN. Te gjashte kategorite e sistemit jane ekuivalente, te barabarta dhe te rendesishme dhe ato perfshijne te gjitha nivelet e nderhyrjes njerezore, te pranueshme per kategorine respektive.

Ne 1981, per here te pare, asete të rralla natyrore u vendosen ne mbrojtjen shtetërore duke shpallur si Monumente te Natyres pyjet me vlere shkencore, biologjike, historike dhe didaktike.

Terminali i depozitave te karburanteve “B-Jera” sha do te vendoset brenda parkut energjitik dhe industrial, ne afersi te ish Uzines Kimike, ne nje zone bregdetare jo pjellore e cila perdorej pjeserisht si vend per hedhjen e mbeturinave nga kjo uzine e mbyllur. Pikerisht ne kete konteks situatë mjedisore prane bregdetare dhe zona neritike e gjirit te

Portoromanos nga zbatimi i ketij projekti per hapsirat e veprimit te tij vihet nen kontroll duke parandaluar ndotjet e metejeshme te ketij mjedisi.

Ne afersi te zones ku do te ndertohet nuk ndodhet ndonje zone e mbrojtur. Por kjo zone perfshihet brenda nje propozimi te UNEP si zone e propozuar per kalimin ne statusin zone e mbrojtur.

Zona eshte e karakterizuar nga mjedise tipike bregdetare pjeserisht ranore dhe pjeserisht shkembore, nje zone e vogel me toka te njoma dhe livadhe te ndryshme te *Posidonia oceanica*. Zona permban komunitete bregdetare te zhvilluara mire. Brigjet sigurojne habitat per “monk seals”, megjithate prania aktuale ne keto zona nuk eshte dokumentuar mire. Speciet endemike, te kercenuara dhe te rrezikuara per tu zhdukur qe gjenden ne rajon perfshijne *Taxus bacata*, *Ceratonia siliqua*, *Pitymys felteni*, *Pitymys thomasi*.



### ***Flora dhe Fauna qe rrezikohet te zhduket***

Megjithese Shqiperia eshte nje vend i vogel, ajo eshte e dalluar per floren dhe faunen e saj te pasur, tiparet specifike te bimesise dhe biodiversitetin e larte.

Ky fenomen shkaktohet nga kushtet specifike ekologjike te lidhura me pozicionin gjeografik te vendit dhe formimin gjeologjik dhe tokesor.

Pavarësisht nga masat e marra, fauna dhe flora kane qene në një presion te madh dhe biodiversiteti i tyre ne disa zona ka pesuar humbje. Masat e marra per ruajtjen e specieve te rralla dhe ne rrezik zhdukjeje te flores dhe faunes perfshihen ne nje urdher special te Ministririt te Bujqesise dhe Ushqimit (Nr.20,data 20.05.1997).

Sipas institutit te Kerkimeve Biologjike për 1997-1998 speciet bimore qe vijojne jane ne rrezik zhdukje ne nivel kombetar :

Dafina, çaji imalit, sherbela, trumza, lisi, gjineshtra, borziloku i eger dhe orkidat. Një studim i kryer ne 1998 nga Instituti i Kerkimeve te Pyjeve dhe Kullotave ka arritur ne konkluzionin se pyjet e plepave te bardhe, te blirit, te dushkut, te mështeknes dhe te verrit konsiderohen si specie te rrezikuara ne nivel kombetar.

<b>Emri</b>	<b>Totali</b>	<b>Te mbrotura</b>
Flora,total	3.250	306
Fauna		
Gjitaret	84	80
Zogjtë	325	311
Amfibët	15	14
Zvarranikët	37	37
Iktiofauna	313	-
Insektet	4.000	

Muzeu i Shkencave i Shqipërisë dhe Instituti i Kerkimeve Biologjike konsiderojne disa specie te flores dhe faunes ne ekosistemet e Bishtit te Palles si endemike, te rralla dhe te kercenuara.

Per zonen e Porto Romanos, perfshire dhe zonen e sheshit te projektit, te dhenat mbi biologjinë detare jane te kufizuara. Perberja dhe situata e komuniteteve detare jane nje reflektim biologjik mbi historine e evoluimit te zones ne aspektet gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrologjike, klimatike etj.

Levizjet tektonike ne Pliocen dhe Kuaternar me depozitat e tyre detare dhe moçalore, pozicioni i zones ne zonen geryese, ekzistenca e nje nenshtrese ranore dhe shkembinjëve, depozitat nga Lumi Erzen, drejtimi i rrymave te detit, ndikimi intensiv ne ate zone etj, kane luajtur nje rol te rëndesishem ne perkufizimin e tipareve te komunitetit detar.

Ne kete zone sedimenti detar mbizoterohet nga rera. Fundi i detit ka te njejten topologji ne te gjithë zonen. Ne disa pjese shume te vogla eshte e pranishme phanerogame *Zostera*, por me nje dendësi shumë më të vogël.

Makrofauna bentonike e kesaj zone eshte e dobet. Midis gastropodëve, me te zakonshmit jane *Cerithium vulgatum* dhe *Bittium reticulatum*, naticidët me *Neverita josephinae* dhe *Natica hebraeus*, muricidet me *Hexaplex trunculus* dhe *Bolinus brandaris*. Gastropode te zakonshem per zonen jane gjithashtu *Turritella communis* dhe *Nassarius mutabilis*. Nga molusqet dyshe, dendesine me te madhe e kane *Donax trunculus* dhe *Chamelea gallina*, ndesa specie si *Tellina planate*, *Tellina pulchella*, *Glycymeris insubrica*, *Laevicardium oblongum*, *Macra coralline* dhe *Corbula gibba* jane te pranishme ne dendesi te vogla.

Numri i pritur i specieve dyshe dhe gjithashtu dendesia e pritur e tyre jane me te larta ne habitate te tilla. Prania e paket e ketyre specieve, si organizma filtrues eshte nje tregues per kushtet e keqia te mjedisit ne ate zone.

Kjo situatë reflektohet gjithashtu nga mungesa e planktonit, i cili eshte nje perberes i rëndesishem i ushqimit te specieve dyshe. Cnidarianet e asaj zone kane nje prani te vogël. Me te zakonshmit ne ujrat bregdetare jane *Rhizostoma pulmo* dhe *Aurelia aurita*.

Nga krimbat polikaete (Anelidët, Polikaetët) speciet me te pranishme jane Eunice aphrodotois, Nereis diversicolor, Sternaspis scutata, Glycera convolute dhe Nephtys hystrixis.

Krustacet jane nje grup tjetër i karakterizuar nga prania e ulet e pasurise dhe dendesise se specieve ne ate zone. Speciet krustace me te zakonshme jane Palaemon elegans, Crangon crangon, Paguristes alatus, Carcinus mediterraneus dhe Macropipus depurator.

Pasuria ne peshq e asaj zone eshte gjithashtu e kufizuar. Perveç faktoreve te tjere, ky fakt eshte gjithashtu i lidhur me situaten e komunitetit makrobentik, siç u permend me siper, i cili eshte baze ushqimore e rendesishme per shume specie peshqish.

Persa i perket iktiofaunes, me mire njihet situata e specieve qe jane objekte te peshkimit. Me te zakonshem jane qefujt gri (Mugil cephalus, Liza ramada dhe Liza saliens), lloje krapit si (Sparus auratus, Oblada melanura), koca (Dicentrarchus labrax), sardelet (Sardina pilchardus) etj. Specie te tjera peshqish te pranishme ne kete zone, por pa ndonje interes te veçantë per peshkimin jane Engraulis encrasicolus, Sprattus sprattus, Atherina hepsetus, Gobius buccini, disa specie phanius etj.

Ne pergjithesi, komunitetet detare ne zonen e zbatimit te projektit mund te konsiderohen si te varfera si ne pasuri dhe bollek speciesh.

Perveç grupeve te permendura me siper, ka grupe te tjera te zakonshme detare te cilat nuk jane te pranishme ose kane nje prani shume te vogel ne zone, si ekinodermat, disa familje te molusqeve, krustaceve, peshqve etj.

Speciet e ketyre grupeve jane te zakonshme ne zonat me te njejten tipologji dhe thellesi, edhe ne distanca te vogla nga zona e projektit.

Varferia e komuniteteve detare ne zonen perkatese mund te jete nje pasoje e ndikimit intensiv njerezor ne te kaluaren.

Pjesa e faunës tokësore përfaqësohet me kafshë si: Canis aureus (fam. Canidae), lepuri i egër, Oryctolagus cuniculus (fam. Leporidae) si dhe nga disa kafshë shtëpiake si lopë, derra, dele, dhi, etj. Amfibët dhe zvarranikët janë të shumtë dhe mund të përmendin bretkocën Rana dalmatica, gjarprin Vipera ammodytes, zhapinj të Lacerta spp. etj

##### ***5. Informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij***

Persa i perket siperfaqes ku do te ndertohet (ne zonen e Portorromanos) burimet ujore jane nentokesore te niveleve nga 90 deri ne 250 metra me debit dhenie deri ne 3-4 litra /sek, shpesh te shoqeruara me permbajtje te dioksidit te hekurit i cili per efekt oksidimi i jep ujit nje ngjyre te kuqeremte kur del ne siperfaqe. Kjo permbajtje eshte relative ne thellesi dhe ne shtrirje pasi ka te bej me kushtet e formimit dhe ruajtjes se baseneve ujor

te pliocenit dhe tortonianit, sidoqofte me rritjen e thellesise bije permbajtja e dyoksideve te hekurit.

Sistemi ujqor bashkiak i Durresit mbeshitet kryesisht ne puse uji, burime, rezervuarë dhe linja shperndarjeje. Familjet ne qytetin e Durresit furnizohen me uje dy deri ne tri here ne dite ne ore te caktuara. Uji merret nga puset e Fushe Kuqes dhe grumbullohet ne rezervuarë para se t'u shperndahet konsumatorëve.

Ne perendim te sheshit ku do te ndertohej shtrihet Deti Adriatik i cili eshte njëri prej dy deteve që lag brigjet e Shqipërisë. Bregu përgjate tij është kryesisht një breg ranor. Në këtë det derdhen lumenjte që rrjedhin përmes tokave shqiptare. Ne zonen ne afersi te Porto Romanos derdhen lumenjte e Ishmit dhe te Erzenit



**Lumi Ishëm** rrjedh përmes Shqipërisë Qendrore (74 km i gjatë; sipërfaqja e pellgut është 673 km<sup>2</sup> dhe lartësia mesatare mbi nivelin e detit 357 m).

Delta e tij ndodhet në Kepin e Rodonit (Kabo, 1990-91). Prurja vjetore mesatare e Ishmit është 20,9 m<sup>3</sup>/s, me modul mesatar të rrjedhjes prej 31,0 l/s/km<sup>2</sup>. Prurja maksimale është 1'980 m<sup>3</sup>/sek.

Sasia kryesore e lëndëve të ngurta që transportohen në det është 2 milionë tonë/vit. Ishmi ushqehet kryesisht nga ujëra sipërfaqësorë me mineralizim relativisht të lartë prej 461 mg/l. Temperatura e ujit luhetet nga 6,12°C në janar deri në 24,7°C në gusht. Ujërat e Ishmit përdoren për vaditje.



**Lumi i Erzenit** është i gjatë 108 km, me prurje rreth 102 l/sek. Erzeni buron nga zona e Gurakuqit, në një lartësi mbi 1300 m mbi nivelin e detit, në lindje të Tiranës, dhe derdhet në Gjirin e Lalëzit, në veri të Durrësit. Në zonën e sipërme të rrjedhës së tij, Erzeni ka gërryer një shtrat të ngushtë në shkëmb, dhe më pas deri në afërsi të Tiranës ka një shtrat me zhavorr, që i le vendin një shtrati më të ngushtë e më baltor pasi i afrohet Durrësit.



Zona ku shtrihet Parku energjistik ka qene nje zone kenetore. Si rezultat i bonifikimit kjo zone pershkrohet nga nje rrjet i dendur kanalesh kullues te cilet mbledhin ujrat sipërfaqesore dhe nentokesore dhe i derdhin ne hidrovorin e Spitalles.



Ne kete zone ndodhen dhe disa rezervuare te vegjel, ujrato e te cilaveve perdoren per ujitjen e kulturave bujqesore.

**6. Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër**

***Lloji i ndikimeve të identifikuar:***

Vleresimi i ndikimeve në mjedis kryhet bazuar mbi parimet e mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

1. Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
2. Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake.
3. Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
4. Parimi i zëvendësimit/kompensimit.
5. Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit.
6. Parimi “Ndotesi Pagan”
7. Parimi i nxitjes së veprimitarive për mbrojtjen e mjedisit.

Ky vlerësim përveç parimeve të sipërpermendura, bazohet në Ligjin 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe në përputhje me kërkesat e VKM-së 686, datë 29.07.2015 “Për zhvillimin e procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis”.

***Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:***

- Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera.
- Ruajtja, Mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe biodiversitetit.
- Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrjen e publikut.
- Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe burimeve të saj.

- Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peisazhit natyror.
- Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit.
- Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.

Per sa më sipër, çdo aktivitet që zhvillohet në mjedis shoqërohet me pasoja dhe ndikime në të, që janë pjesë e atij komponenti që shoqëria jone ka zgjedhur për t'u zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqës së tyre dhe me analitikisht ndikimet e çdo operacioni të kryer. Vlerësimi i ndikimeve të mundshme si pasoje e veprimtarisë bëhet duke u nisur nga një sërë faktorësh që lidhen me natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur për ndërtim, mënyrën e funksionimit, sasinë e energjisë, lëndët e para të përdorura dhe mbetjet e gjeneruara, të gjitha këto në kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik.

Bazuar në llojin e projektit të propozuar ndikimet më thelbësore mund të analizohen sipas dy fazave të veprimtarisë

1. Në fazën e ndërtimit të objektit
2. Në fazën e funksionimit të objektit

Është e rëndësishme të kuptohet natyra e këtyre proceseve dhe forma e shfaqës së tyre, direkte ose indirekte, në mënyrë që të përcaktohet qartë lloji i ndikimeve. Duke analizuar edhe shtrirjen në kohë të këtyre ndikimeve ato klasifikohen:

3. Ndikime të kthyeshme në mjedis
4. Ndikime të pakthyeshme në mjedis

Të dy llojet e ndikimeve mund të minimizohen në formë të ndryshë, në terma relative ku qëllimi kryesor është mbajtja e tyre brenda sipërfaqes së objektit të kërkuar dhe krijimi i kushteve natyrore për të siguruar riaktivizimin e proceseve të natyrës dhe rigjenerimit të ekosistemit.

Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqen hapat e mëposhtem:

- Njohja me projektin në fazat e ndërtimit
- Njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis
- Njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes
- Konsultimi me dokumentet ligjore dhe administrative dhe raporte VNM-je për veprimtari të tjera.

Ndërtimi i Terminalit të depozitimit të karburanteve B-Jera sha, Porto Romano, Durrës do të jetë një investim i ri. Pozicioni i vendndodhjes së pontilit, sipërfaqja në dispozicion, investimet që do të kryhen, linja teknologjike që është përzgjedhur e t.j. që në fillim të japin përshtypjen se raporti *Benefit/pollution* është pozitiv.



### *Efektet positive ne mjedis.*

Shoqeria B-Jera sha ka hartuar projektin dhe studimet perkatese per ndertimin dhe shfrytezimin e nje terminali per depozitim e nenprodukteve te naftes

Eksperienca e kesaj shoqerie ne fazen e implementimit te projektit dhe te operimit te perditshem ka shume rendesi ne aspektin e masave te pergjitheshme per parandalimin e ngjarjeve te jashtezakoneshme dhe te mbrojtjes ndaj zjarrit si dhe mjedisit.

Mbi kete baze eshte ndertuar edhe struktura e masave mbrojtese ku perfshihen elementet kryesore te zbatimit te legjislacionit ne fushen e mbrojtjes se mjedisit duke perfshir dhe regulloret e instruksionet sipas natyres konkrete te aktivitetit

Nje rendesi ne aspektin e rrisqeve dhe masave mbrojtese i eshte dhene dhe permasave te aktivitetit periodik qe do te kryej shoqeria ne kete fushe. Specifik konsiderohet aktiviteti i shoqerise ne aspektin e volumeve qe parashikon te qarkulloj ne menyre periodike, te cilat jane te konsiderueshme dhe per pasoj duan kujdes te vecante.

Shoqeria B-Jera sha nje rendesi te vecante i ka kushtuar sistemit te monitorimit dhe sensoreve qe do te jene teknologji bashkohore vetevepruese dhe qe do te mbulojne ne menyre uniforme te gjithe teritorin e veprimtarise perditeshme .

Karakteristike per kete aktivitet teknologjik eshte se ne skemen teknologjike funksionojne nyje te ndryshme te cilet jane ene nen presion dhe duan monitorim dhe masa specifike per mbrojtjen e mjedisit dhe parandalimin e ngjarjeve te jashtezakoneshme.

Edhe pse shoqeria ka hartuar nje projekt bashkohor per realizimin e ketij aktiviteti, nga pikpamja mjedisore, me qellim mbrojtjen e ambientit dhe parandalimin e ngjarjeve te jashtezakonshme paraprakisht eshte bere nje studim dhe program menaxhimi me masa te percaktuara si shoqeri dhe individ per te gjithe fazat e veprimtarise qe nga parapergatitja deri tek shfrytezimi.

Interferenca qe ka ky aktivitet me mjedisin eshte e dyaneshme. Ne aspektin teknologjik ai ka si objekt manipulimi nje lende e cila zoteron ne te njejten kohe dy gjendje fizike ate likuide te lenget dhe volative. Prandaj, sipas projektit sistemi i monitorimit te emetimeve ne ajer dhe rjedhjeve eshte bashkohor dhe nga teknologjite me ne ze.

Gjithashtu ky aktivitet ka dhe impakt pozitiv ne aspektin social. Projektii parashikon nje punesim te mundshem per banore te kesaj zone, se dyti permiresim e infrastruktures dhe se treti permiresim te sistemit mjedisor ne kete teritor industrial te falimentuar dhe te lene jashte kontrolli para vendosjes se kesaj industrie.

Nga pikpamja e peisazhit, ndertesa dhe nyja teknologjike nuk do te luaj ndonje rrol perkeqesues, perkundrazi, konceptimi arkitektonik do i rriti vlerat.

Efektin pozitiv do ta shtojne dhe investimet e parashikuara per infrastrukturen dhe gjelberimin.

Ne nyjen teknologjike si burim energjie perdoret energjia elektrike qe do te sigurohet kryesisht nga rjeti elektrik. Ne raste shume te rralla energjia elektrike do te sigurohet nga nje gjenerator.

Gjate procesit te ndertimit te ndertesës dhe nyjes teknologjike shoqeria do te zbatoje te gjithë regullat teknike per minimizimin e emetimeve ne ajer ne forme pluhuri.

Shkarkime ne ajer ne rastet kur punon gjeneratori dhe nga karburanti i makinave, duke patur parasysh kohen e perdorimit, kohen e qendrimit te makinave per furnizim e tj, nuk perbejne rrezik ndotje.

Shkarkimet e zeza do te jene te sistemuara ne gropa septike. Kjo e fundit do te ndertohet me beton te pa pershkrushem duke siguruar mos ndotje te tokës dhe ujrave nentokesore.

Ne projekt, per vet specifikën e aktivitetit, eshte parashikuar ndertimi i nje sistemi modern i sinjalizimit dhe i mbrojtjes nga zjari, si per proceset e ancorimit, ashtu dhe te evadimit te lendës djegese drejt tankerave.

Zhurmat nuk perbejne problem shqetesues per banoret perreth per aresye te distancave nga shtepite e banimit, dhe te procesit teknologjik.

Mbetjet e ngurta do te derdhen ne piken e grumbullimit, nderkohe qe shoqeria do te kontraktoje me kompanine e sherbimeve per evadimin e tyre ne lendfillin e Durresit..

### ***Efektet negative ne mjedis.***

- Potencialisht, gjate aktivitetit te terminalit te depozitave B-Jera sha, Porto Romano, Durres mund te hasim ne efekte negative ne mjedis si:
- Ndotja siperfaqesore dhe e ujrave nentokesore
- Ndotje e ujit te detit mund te shkaktohet nga difekte ne nyjen lidhese te tankerave te anijeve me sistemin e percielljes se gazit ose hidrokarbureve, demtimit te tubacioneve te percjelljes etj.
- Ndotja e mjedisit si pasoje e zhurmave qe mund te shkarkohen nga motorat dhe burite e makinave.
- Ndotja e mjedisit nga mbeturinat e ngurta.
- Ndotje e ajrit.

*7. Një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve*

***Shkarkime te rendesishme gjate ndertimit te projektit te propozuar***

Sic e kemi permendur edhe me lart, terminali do te ndertohe brenda Parkut Energjistik dhe Industrial te Porto Pomanos. Aktualisht ne kete park jane ndertuar impiante depozitash per kompani te ndryshme. Ne kete konteks, ndertimi i Terminalit te depozitave te karburanteve B-jera sha i pershtatet ndertimeve teknologjike ekzistuese dhe nuk luan ndonje rol negativ ne drejtim te peisazhit

Gjate fazes se ndertimit te objektit “Terminal per depozitim e karburanteve” te “B-Jera” sha nuk do te kemi infiltrime te ujerave te ndotur, lubrifikanteve apo solveneteve ne toke dhe ujrat nentokesor.

Ujerrat qe dalin nga aktiviteti i ndertimit te objektit jane ujera te cilat gjenerohen si rrjedhoje e aktivitetit te lagies se territorit/kantierit, larjes se gomave te automjeteve dhe ujerrat e reshjeve te shiut. Gjate ndertimit ne varesi dhe te sasise se reshjeve mund te grumbullohen sasi te konsiderueshme te ketyre ujerave dhe mund te linde nevoja e orientimit te tyre drejt sistemit te kanalizimeve. Pjeserisht keto ujera mund te infiltrojne dhe ne toke por pa ndonje rrisht te vleresuar. Si rrjedhoje, punimet e ndertimit nuk duhet te tejzgjaten, por te zbatohen kushtet dhe afatet e percaktuara ne lejen e ndertimit.

Nuk duhet te shkarkohen lende te demshme ne mjedisin e kantierit pasi mund te infiltrojne se bashku me ujerrat e reshjeve dhe si rrjedhoje te ndotin ujerrat nentokesore.

Ne kantier nuk do te magazinohen material te rrezikshme dhe si rrjedhoje nuk do te kete ndotje te ujerave nentoksore dhe siperfaqesore. Mundesite e ndotjes mund te vijne vetem nga derdhja e karburanteve ose e lubrifikante gjate momentit te furnizimit te mjeteve te renda.

Nje factor tjeter mund te jene ujerrat e pastrimit e te larjes se kazaneve te betoniereve gjate shkarkimit te betonit ne kantier. Keto te fundit, nuk duhet te shkarkojne ujerrat ne cdo mjedis rrethor, ato duhet te shkarkohen ne mejdise te caktura dhe ne kantieret e prodhimit te betonit.

Punimet e themeleve do te jene per nje peiudhe te shkurter kohere dhe mundesia e shkarkimit te ketyre ujerave zvogelohet ndjeshem.

Emetimet ne ajer vijne nga perhapja e pluhurave te materialeve te ndertimit dhe materialit te germuar te siperfaqes se tokes, nga djegja e lendes djegese, qe shkaktohet nga automjetet qe do te levizin ne kantier dhe ne raste te rralla nese ka mungese te energjise lektrike nga funksionimi i gjeneratorit, nga punimet ndertuese dhe qarkullimi i mjeteve, nga perdorimi i reres, zhavorrit, proceset e betonimit dhe shtrimit te siperfaqeve perreth me asfalt, si dhe nga transporti i automjeteve per zhvendosjen e dheut te germuar apo te mbetjeve inerte te prodhuara gjate ndertimit.

Keto mjete duhet te plotesojne kushte teknike te qarkullimit rrugor, te mos ngarkohen me shume se kapaciteti i projektuar, te mbulohet karrociera me mushama te posacme, si dhe te lahen rregullisht kur te dalin nga kantieri i ndertimit dhe kantieri i prodhimit te betonit, te inerteve apo ne sheshin e depozitimit te dheut te germuar.

Zhurmat qe gjenerohen vijne kryesisht nga mjetet rrugore dhe mjetet e renda (vincat, fadromat, askavatore, gjeneratore) te cilat do te punojne ne kantier. Gjithashtu mund te gjenerohen zhurma dhe nga vete personat qe do te punojne per kete kantier, proceset e punes (hedhja e betonit, vendosja e skelerise, pajisjet e prerjes se hekurave etj). Subjekti ndertues nuk mund te punoje gjate oreve te vona.

*Ndikimi ne toke*-Proceset e ndertimit te terminalit nuk kane ndikim direct ne toke pasi sheshet do te jene te shtruara dhe nuk do te kete kontakt mjedisor tokesor, por meqenese strukturat qe do vendosen mbi keto sheshe do te jene permanente, impakti do te jete i pakthyeshem.

Ndikimi i ketij aktiviteti si ne fazen e ndertimit ashtu edhe te funksionimit ne mjedisin social, mund te jete pozitiv, kjo per sa i perket punesimit, sherbimit qe ofron, konkurrences etj.

Mbetjet e ngurta te prodhuara nga ndertimi ne kete zone jane mbetje te ngurta urbane si qelqi, plastike, material letre, metali, mbetje organike, material inerte te prodhuara nga punimet ndertuese si dhe dheu dhe mbetje inerte qe do te largohen nga sheshi i ndertimit. Pjesa e mbetjeve te paperdorshme duhet te grumbullohet ne vendin e caktuar nga Njesia e Qeverisjes Vendore (NJ.Q.V) pas zbardhjes se Lejes se Zhvillimit nga autoritete pergjegjese. Mbetjet duhet te menaxhohen ne bashkepunim me NJ.Q.V-ne dhe firmen pastruese te territorit ne perputhje me V.K.M-ne 575, date 24.06.2015, "Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte"

### ***Shkarkime te rendesishme gjate funksionimit te projektit te propozuar:***

Gjate funksionimit te Terminalit te Depozitimit te Karburanteve nuk do te kete ndotje te ujerave nentokesore. Ujerat qe dalin nga aktiviteti human ne objekt jane ujera urbane te cilat do te shkarkohen ne sistemin e kanalizimeve te zones. Gjithashtu do te kete dhe ujera te larjes se ambjenteve perreth ambjentit dhe mjeteve te cilat do te derdhen ne sistemin e kanalizimitin e ujrave te bardha.

Emetimet ne ajer nga funksionimi i ketij aktiviteti do te kemi ne formen e gazrave dhe aromave. Teknologjia e ndertimit te depozitave, menyra e mbushjes dhe e shkarkimit te tyre etj, e minimizojne kete efekt. Megjithate mund te kete raste avarishe e difektesh per eliminimin e te cilave duhet te kete nje plan te vecante masash

Ne terminal nuk do te kete impiante me djegje dhe nuk do te kete shkarkime te gazeve te demshem per mjedisin. Emetimet ne ajer mund te vijne vetem nga levizja e mjeteve ne sheshin e terminalit dhe nga perdorimi i gjeneratorit, ne rast te nderprerjes se Energjise

Elektrike. Keshillohet qe gjeneratori te jet tip silencioz me lende djegese nafte te paster, te perpunuar me paarmetrat e shitjes ne treg.

Mbetje te ngurta qe do te prodhohen/gjenerohen nga konsumi i perditshem ne objektin qe propozohet do te jene te formave: plastike, material letre, mbetje organike etj. Keto mbetje duhet te menaxhohen dhe diferencohen ne burim dhe te depozitohen ne venddepozitim e caktuar nga NJ.Q.V-ja.

Emetime te zhurmave nga zhvillimi i ketij aktiviteti, ne prgjithesi nuk do te kete. Objekti eshte me funksion depozitimi dhe nuk do te zhvillohen aktivitete qe zhvillohen zhurma ne mejdis. Gjeneratori do te jete tip silencioz, i pajisur me system te humbjeve te zhurmave dhe do te jete i instaluar ne ambient te mbyllur

#### ***8. Informacion per kohezgatjen e mundeshme te ndikimeve negative te identifikuar***

Punimet ndertimore, mund te zgjasin ne nje peiudhe 12-18 mujore. Kjo eshte koha normale per te perfunduar se ndertuari projekti i propozuar. Kjo eshte e vlefshme ne kushte teknike, juridike e klime normale. Por ne rast se do te hasen veshtiresi gjate punimeve mund te kemi nje shtyrje te afatit edhe per nje periudhe 6-mujore. Si rrjedhoje dhe ndikimet e fazes ndertimore do te zgjasin per aq kohe sa zgjasin punimet per ndertim.

Per sa i perket ndikimeve gjate fazes se funksionimit ato do te jene prezente per aq kohe sa do te perdoret edhe objekti, keto ndikime nuk jane me rendesi te vecante, pasi jane te krahasueshme me cdo objekt tjeter banimi, sherbimesh apo tregtar qe ndodhet ne zonen e Tiranes. Gjithashtu duhet te theksojme se Plani urbanistik e ka percaktuar kete zone si industriale. Te gjitha ndikimet e siperpermendura nuk jane te perhershme dhe afatgjata, ato jane te perkoheshme dhe afatshkurter.

Ndikimi ne peisazh do te jete i perkoheshem ne fazen e ndertimit dhe i perhershem gjate fazes se funksionimit nga zenia e hapesires dhe ndertimi i strukturave. Projektuesit e projektit te propozuar jane siguruar qe territori te kete gjelberim te mjaftueshem gje e cila do te jape nje imzh visual te kendeshem.

#### ***9. Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të***

Zona ku eshte planifikuar dhe pjeserisht ndertuar Parku Energjistik dhe Industrial eshte larg zonave te banuara.

Terminali per depozitim e karburanteve B-Jera sha do te ndertohet ne brendesi te parkut energjistik.

Projekti do te shoqerohet me masat zbutese te cilat do te minimizojne ndikimet negative si ne kohe dhe hapesire.

Ne kete menyre, gjate fazes se funksionimit, ndikimi ne mjedisin e zones do te kete efektet e tij ne nje distance jo shume te gjere, pra ne nje distance jo me te larget se 150-200 m.

Ky ndikim gjate fazes se ndetimit do te jete i perkoheshem dhe nuk akumulohet ne mjedis. Sic e kemi pershkruar do te kete efekte negative te perkoheshme kryesisht ne ndotjen e ajrit si rezultat i transportit te dherave dhe inerteve ne distanca deri 1.5 km.

***10. Mbi mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin***

Subjekti investitor, vete ose nepermjet firmes ndertuese te kontraktuar, duhet qe pas perfundimit te ndertimit te objektit dhe infrastructures perkatese, te kryeje rehabilitimin e plote te sipefaqeve te lira, si ato te shtruara me beton apo pllaka, per rruget hyrese, sheshe parkimi dhe per siperfaqet e gjelberta.

Duhet te mbillen peme ne perimetrin e prones per te reduktuar ndikimin ne peisazh, si dhe brenda mundesive te mbillen peme qe i rezistojne kushteve klimatrike te zones, pra te mbillen peme autoktone, endogjene. Siperfaqja e zones te shnderrohet ne nje mjedis te gjelbert dhe te paster.

***11. Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis***

***11.1 Plani i menaxhimit te mjedisit***

**Roli i shoqërisë “B-Jera” sha lidhur me menaxhimin mjedisor**

***Pergjegjesite***

Si propozuese e projektit, shoqëria “B-Jera” sha do të ketë përgjegjësinë themelore për zbatimin e PMM, i cili do të përfshijë:

- Menaxhimin në vazhdimësi të çështjeve mjedisore sipas ecurisë së projektit të detajuar;
- Monitorimin e performancës së kontraktorëve;
- Zhvillimin e mekanizmave për zgjidhjen e problemeve;
- Funksionimin si pikë kontakti për konsultime dhe sqarime me pronarët e tokës, publikun dhe palët e interesuara.

***11.2 Monitorimi i përgjithshëm mjedisor, monitorimi mbi përmbushjen e detyrimeve sociale dhe raportimi.***

Shoqëria “B-Jera” sha do të garantojë që aktivitetet e kontraktorëve të saj do të kryhen në përputhje me standardet përkatëse që do të përcaktohen. Performanca e kontraktorëve lidhur me përmbushjen e detyrimeve të PMMS do të monitorohen dhe kontrollohen. Zbatimi ose jo i standardeve të parashikuara në PMM do të regjistrohet dhe këto të dhëna do të vihen në dispozicion për inspektim të përfaqësuesve të kontraktorëve dhe autoriteteve shqiptare.

### ***Roli i kontraktorëve lidhur me menaxhimin mjedisor***

Kontraktorëve të punësuar nga shoqëria “B-Jera” sha do tu kërkohet të zhvillojnë dhe tu përmbahen dispozitave të PMM dhe të marrin përgjegjësi për zhvillimin e vazhdueshëm të saj përgjatë periudhës së përfshirjes në zbatimin e Projektit. Kontraktorët do të jenë përgjegjës për të garantuar zbatimin e:

- Gjithë legjislacionit përkatës;
- Masave të kontrollit dhe zbutjes së ndikimit mjedisor që përmban PMM;
- Rregulloreve të tjera mjedisore, social-ekonomike apo kodeve të sjelljes, kërkuar nga shoqëria “B-Jera” sha.

### ***11.3 Reabilitimi dhe parandalimi i njëjarjeve të jashtëzakonshme***

Shoqëria duhet et hartojë një Plan për Menaxhimin e Incidenteve (PMI) si një kuadër për menaxhimin e krizave dhe emergjencave, i cili duhet të integrohet brenda projektit në të gjitha fazat.

Qëllimi i planit është të identifikojë pajisjet, procedurat, trajnimet dhe personelin e nevojshëm për të mbrojtur fuqinë punëtore, klientët, publikun, mjedisin dhe reputacionin e shoqërisë në rast të një incidenti.

### ***11.4 Permbledhje e masave zbutëse***

Në identifikimin e masave zbutëse, theksi është vënë në teknikat e parandalimit të ndotjes të cilat përfshijnë teknologji me të pastra dhe minimizim të mbeturinave. Teknologjitë e identifikuar janë pjesë e një game të gjere teknologjish të përdorura që konsiderohen të jenë praktikë me të mira aktuale për qëllimet vëndosjes të vlerave kufi të çlirimeve.

Gjithashtu do të nderrmerren masa të tilla si ndryshime të brendshme në impjant, zëvendësime të lendeve të para, rimodernizim të proceseve dhe praktika të përmirësuar të përpunimit dhe depozitimit të materialeve në mënyrë që të reduktohen çlirimet.

Përveç instalimit të pajisjeve dhe operimit të procedurave për reduktimin e çlirimeve të mundshme, për të minimizuar ndikimet potenciale, është e këshillueshme të adoptohet një program i vazhdueshëm për menaxhimin dhe kontrollin e mjedisit, i cili do të

fokusohet ne permiresime te vazhdueshme me qellim parandalimin, eliminimin dhe/ose reduktimin progresiv te çlirimeve.

Masat zbutese per ndertimin dhe fazat operacionale jane permbledhur ne Tabelat respektive. Keto tabela identifikojne masat zbutese qe duhen te implementohen per te minimizuar efektin e parashikuar te secilit aktivitet. Te gjitha çështjet e planit zbutese duhet te konsiderohen si praktika te mira inxhinierike dhe praktikate me te mira te menaxhimit.

Ne aspektin e teknologjise shoqeria **B-JERA SHA** eshte e interesuar te instaloj nje teknologji bashkohore e cila zvogelon koeficientin e humjeve nepermjet riciklimit te fazes se gazte. Ky element sjell nje hop teknologjik i cili ka efekte pozitive ne ruajtjen e mjedisit, afatgjat per gjithe procesin e operimit.

Sikurse dihet per cdo projekt, dy jane fazat te cilat mbyllin ciklin e aktivitetit te nje teknologjise nga projektimi ne zbatim. Eshte faza e ndertimit dhe instalimit te teknologjise dhe faza e operimit pas venies ne funksion te objektit te projektuar .

Aktualisht terreni ne te cilin do te zbatohet ky projekt eshte ne kushte shume te favoreshme ne raport me investimet filestare qe jane bere ne kete zone per ndertimin dhe shfrytezimin e depozitave bregdetare. Infrstruktura eshte permiresuar ne menyre te konsiderueshme gje qe favorizon zvogelimin e kostove operacionale si ne fazen e implementimit te projektit po ashtu dhe te shfrytezimit tij.

Gjithashtu infrastruktura dhe mjedisi urban i permiresuar ndihmon dhe ne zbutjen e masave mbrojtese per mjedisin ne kohe dhe kosto. Vecanerisht ky efekt ndihet ne menaxhimin e mbetjeve te ngurta dhe te lengta te cilet ne keto kushte jane lehtesisht te administrueshme .

Me poshte po japim tabelen e masave zbutese per secilen faze e cila perben dhe nje nga programet praktik per te siguruar mbarvajtjen e nevojeshme ne aspektin mjedisor per te dy stadet e lartepermendura .

***Masat zbutese te fazes se ndertimit***

<b>Aktiviteti</b>	<b>Efektet mundshme</b>	<b>Masat zbutese</b>
Punime në tokë Derdhja e mbeturinave te lengshme	Ndotja mundshme e ujit	Nje impjant per trajtimin e ujrave te zeza do te sigurohet ne zone. Nuk do lejohet derdhje e mbeturinave te lengshme.



<p>Punime ne toke dhe kullimi i ujrave</p>	<p>Depertim i sedimenteve, vajit dhe grasos ne rrjedhjet ujore te aferta</p>	<p>Duhet te pergatitet me shkrim nje plan pergjigje emergjence dhe te mbahet ne zone. Uji qe mund te ndotet me vaj do te drejtohet te nje ndares uje/vaj(OES) brenda impjantit. OES zakonisht heqin vajin nën limitet shqiptare prej 20 ppm per sasine totale te hidrokarbureve. Per te parandaluar derdhjen e materialeve te lengshme duhen marre masat e meposhteme zbutese:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Veçim i gjithe mbeturinave vajore dhe i lubrifikanteve qe dalin nga mirembajtja e pajisjeve teknologjike dhe largimi i ketyre mbeturinave ne menyren e duhur.</li> <li>-Ndertimi i argjinatutave mbajtese per te gjitha çisternat</li> <li>-Ndertimi dhe mirmbajtja e pajisjeve per te larguar ujin e shiut nga strukturat e mbajtjes dytesore dhe largimin e naftes nga siperfaqe e materialit te akumuluar.</li> </ul>
<p>Punime ne toke. Përgatitja e zones dhe aktivitete te pergjithshme ndertimi</p>	<p>Emetimet e pluhurave nga pajisjet</p>	<p>Per minimizimin e prodhimit te pluhurit gjate ndertimit, duhet te behet sa me shpejt asfaltimi i rrugeve te brendshme dhe te jashteme.</p> <p>Rruget e ndotura, zonat e ekspozuara te ndertimit dhe grumbujt e materialeve inerte gjate stines se thate duhet te lagen.</p> <p>Duhet te perdoren hinka te pjerreta per shkarkimin e materialeve dhe duhet te ulet shpejtesia e kamioneve.</p>
<p>Punime në tokë- Përgatitja e sheshit dhe aktivitete te pergjithshme ndertimi.</p>	<p>Clirimi i tymrave te djegies nga pajisjet.</p>	<p>Mjetet e ndertimit që do te perdoren duhet te mirmbahen rregullisht, qe sjell si rezultat djegien e mire te lendeve djegese dhe nxjerrjen e tymrave ndotes te paket.</p> <p>Numri i pajisjeve te ndertimit do te jete i vogel.</p>
<p>Punime ne toke- Shperndarja e pajisjeve dhe materialeve</p>	<p>Trafik dhe pluhur i shtuar</p>	<p>Përmiresimi i rruges se hyrjes per ne impjant. Pluhuri i rruges duhet te minimizohet duke perdorur lagjen me uje gjate ndertimit dhe duke krijuar siperfaqe te asfaltuara.</p> <p>Shpejtesia e mjeteve ne rruge do te kontrollohet për të ulur mundesine e aksidenteve.</p>

Punime në toke- Përgatitja e sheshit dhe aktivitete te pergjithshme ndertimi.	Zhurma nga pajisjet	Pajisjet e ndertimit do te jene konform standarteve që aplikohen sipas Direktives 2000/14/EC të BE të Majit 2000. Kjo directive aplikohet per prodhimin e pajisjeve që lëshojne zhurmë. Punimet që shkaktojne zhurme shqetesuese duhet te minimizohen gjate diteve te pushimit. Të gjitha pajisjet do te mbahen ne gjendje te mire pune.
Punime ne tokë- Menaxhimi i dherave te ndotura	Shqetesime te mundshme te shendetit	Dheu i ndotur (40.000m <sup>3</sup> ) do te ruhet ne menyre te sigurt nën zona te asfaltuara per te shmangur mobilizimin e ndotesve.
Punime ne toke- Menaxhimi i mbeturinave industriale dhe inerte	Shqetesime te mundshme te shendetit	Kontraktuesve te ndertimit do t'u kerkohej te mbledhin veç e veç fraksionet e ndryshme të mbeturinave dhe t'i largojne ato ashtu siç duhet.
Punime ne toke- Forca e punes ndertuese	Fluksi punëtorëve krijon presion mbi banesat dhe trafikun	Fluksi punëtorëve nuk pritet te kalojë 50 individë (duke marre parasysh punimet ndertimore dhe ato teknologjike ). Pjesa më e madhe e punëtorëve do te jetojë në Durres dhe do te arrijë lehtësisht ne zonë.
Furnizimi me ujë te pijshem	Redukton furnizimin me uje per banoret	Furnizimi me uje per perdorimin ne aktivitetet e ndertimit duhet te monitorohet per t'u siguruar që nuk ndikon negativisht ne perdorimet e tjera te ujit ne zone.
Përfundimi i punimeve	Panoramimi	Siperfaqja e tokes do te nivelohet dhe mbillet siç duhet. Përgjate kufirit te zones do te mbillet nje numer i caktuar pemesh (si psh pisha dhe brukë) për të zbukuruar Terminalin
Germimi (zona e Depove)	Ndikime te drejtperdrejta në jetën marine dhe ne habitat	Koordinatat përfundimtare të zones së hedhjes së mbeturinave do te finalizohen të bazuara ne nje studim batimetrik të nje shkalle te madhe te kryer nga kontraktuesi.
Germimi (zona e shkarkimit të materialit të gërmuar)	Ndikime te drejtperdrejta ne jeten marine dhe ne habitat	Metodat e hedhjes së mbeturinave do te jene pjese e nje programi te detajuar gërmimi qe do te monitorohet nga drejtuesit teknik te firmes nenkontraktore.

Germimi (zona e Depove)	Përhapje e materialit të hollë nga sedimentet  Shperndarja e sedimenteve pezull (cilësia e ujit dhe efektet e terthorta në jetën detare)	Kerkesat për mjedisin dhe kufiri i derdhjes (5% ) të jetë pjesë e specifikimeve në kontratë.  Një ekspozim i detajuar i metodës dhe i programit të germimit do të përgatitet nga kontaktuesi sipas direktivave të BE-së për ndërtimin e terminaleve dhe depozitave bregdetare.
Germimi(zona e hedhjes)	Shperndarja e sedimenteve pezull (cilësia e ujit dhe efektet e terthorta në jetën detare)	Në mënyrë absolute nuk do të shperndahej materialet humurore të pastrimit të sheshit të ndërtimit, apo i germimit të themeleve në pjesën pranë bregdetare, neritike apo lagunore gjë që mund të sjellë dëmim të habitatit ose ekosistemit në përgjithësi..

Masat për uljen dhe kontrollin e çlirimeve gjatë fazës së operimit janë përshkruar në tabelën e mëposhtme. Keto përfshijnë:

- Minimizimin e ngarkesës
- Permbajtjen
- Rekuperimin/Riciklimin
- Pakesimin e çlirimeve
- Trajtimin dhe largimin e mbeturinave.

#### Masat zbutëse për fazën e shfrytëzimit

Aktiviteti	Efektet mundshme	Masat zbutëse
Pjesa tokësore e Depove. Pajisjet e ngarkim-shkarkimit	Çlirimet VOC	Një sistem mbledhje dhe rekuperimi i avullit që mbledh avujt e benzines dhe të gazoilit nga autoçisternat dhe i dërgon tek njesia e rekuperimit (VRU) do të realizohet sipas Rregullores Europiane 94/63/E për nxjerrjet VOC
Pjesa tokësore e Depove-Cisternat e benzines	Humbjet avulluese nga benzina e depozituar	Cati lundruese me dopio hermetizim
Levizjet e kamionëve për ngarkimin e produkteve	Trafiku	Lidhja me hekurudhën lejon reduktimin e numrit të udhetimeve të kamioneve brenda dhe jashtë depove të B-JERA sha

Levizjet e kamioneve per ngarkimin e produkteve	Clirimet e tymrave dhe blozes se djegies	Lidhja hekurudhore dhe permiresimi i rruges kryesore hyrese ne depo
Pjesa tokesore e Depove-Derdhjet nga depozitat e naftes dhe benzines.	Ndotja e mundshme e ujit	Cisternat do te pajisen me nje sistem per zbulimin e rrjedhjeve. Shtrimi me beton i baseneve te ruajtjes do te lejoje mbledhjen efektive te derdhjeve. Konstruktimi i tubacioneve kulluese ne çatine lundruese të depozitave të benzines do te shmang ndotjen me hidrokarburë te ujit te shiut.
Pjesa Tokesore e Terminalit-Derdhjet nga depozitat e naftes dhe benzines.	Ndotja e mundshme ujit	Uji i ndotur me vaj do te trajtohet para se te derdhet ne mjedis. Uji potencialisht i ndotur me vaj do te drejtohet tek ndaresi ujë/vaj i zones (OES). Sistemi per trajtimin e ujit eshte projektuar per te hequr vajin nën kufirin Shqiptar prej 20ppm per sasine totale te hidrokarbureve.
Pjesa tokesore e Depove-manaxhimi i mbeturinave te lengshme	Ndotja e mundshme e mjedisit	Nafta/shkuma e nxjerre nga ndaresi ujë/naftë dhe nga njesia e flokulimit do te riciklohet ose po te jete e nevojshme do te depozitohet dhe do ti nënshtrohet periodikisht trajtimit të përshtatshem para se te derdhet.
Pjesa tokesore e Depove-Manaxhimi i mbeturinave te ngurta.	Ndotja e mundshme e mjedisit	Tipet, sasite, data dhe menyra e largimit të të gjithë mbeturinave të rëndesishme do te shënohen në regjistër.
Pjesa tokesore e Depove-Manaxhimi i mbeturinave te ngurta.	Ndotja e mundshme e mjedisit.	Punëtoreve do t'u kerkohet te mbledhin veç e veç fraksionet e ndryshme te mbeturinave.
Derdhjet e naftes (operimet normale dhe aksidentale)	Ndotja e ujit	-Pergatitja dhe menaxhimi i Planit te Kontrollit per parandalimin e derdhjeve dhe kundermasave. -Pershtatja me standartet e sigurisë (ISGOTT) -Gadishmeria e pajisjeve per kontrollin dhe rikuperimin e derdhjeve te nivelit 1 dhe 2, qe perfshijne perafersisht 500 km kufizues naftë, varkë rrethimin e njolles se naftes, substance lidhese dhe thithëse. -Koordinimi me Autoritetet kompetente per te percaktuar procedurat qe duhen ndjekur ne rastin e nje derdhje te nivelit te tretë.

Ujrat e zeza /largimi		Tek zonat e operimit do te kete drenazhim, depozitë per ujin e larjes dhe drenazhim – trajtim ne ndaresin API
Operimi dhe mirmbajtja.	Zhurma	Praktikat me te mira te menaxhimit.
Operimi dhe mirmbajtja	Ndotja e ajrit	

## ***12. Zbatimi i planit te menaxhimit***

### ***Faza e ndertimit***

Ndetimi i depozitave bregdetare te shoqerise B-JERA sha do te kontraktohet sipas parimit EPC (Inxhiniering, Prokurim, Ndertim) me nje ose me shume kontraktues, te bazuar ne nje procedure kualifikimi dhe tenderimi.

Zbatimi praktik i masave zbutese kerkon:

- Çeshtjet e mjedisit do te formojne subjektin e nje seksioni specific te Detyres se Zbatimit
- Specifikimet teknike te Detyres se Zbatimit do te perfshije te gjitha referencat e nevojshme per praktikat me te mira te manaxhimit te zones se ndertimit. Specifikimet do te mbulojne parametrat respective nga kendveshtrimi ambjental, si psh kufiri i derdhjes per punimet e germimit, karakteristikat e materialit çakull, metodat e ndertimit, kerkesat per pajisje.
- Pjesmarresve ne tendera do t’iu kerkohet te perfshijne ne oferten e tyre nje propozim per planin e ekzekutimit. Ky do te perfshije nje pershkrim te metodave te propozuara te ndertimit, hollesi mbi pajisjet dhe nje dokument specific qe trajton te gjitha aspektet e menaxhimit te mjedisit
- Dokumentat e mesiperme do te jene pjese e dokumentave kontraktuale dhe do te ndiqen me korrektesi nga kontraktuesi i zgjedhur (përgjegjësi e kontraktuesit EPC)
- Supervizioni do te kryhet nga nje personel me eksperience ne menyre qe te monitorohet perputhja me specifikimet.

### ***Faza e operimit***

B-JERA ShA do te jete pergjegjese per operimin korrekt ne impjantin e depozitave bregdetare qe do te ndertohen ne sheshin e ndertimit te miratuar nga organet perkatese, brenda kontureve te masterplanit te zones energjitike dhe industriale te Portoromanos, sipas Legjislacionit Shqiptar dhe standarteve nderkombetare te sigurise te listuara dhe do te mbaje pergjegjesine per zbatimin e masave te permbledhura ne table.

Elementi kyç per t’u zbatuar eshte Plani Kontrollit te Parandalimit te Derdhjeve te Kundermasave (Plani SPCC)

Ky plan duhet t'i adresohet qarte çështjeve te meposhteme:

- Proçedurat e punes per parandalimin e derdhjeve te vajit;
- Masat e kontrollit te instaluara per te ndaluar derdhjet e naftes te depertojne ne ujrat e lundrueshem;
- Proçedurat e inspektimit dhe mirembajtjes ne lidhje me burimet e mundshme te derdhjeve (pajisjet, tubacinet);
- Organizimi i skuadres se pergjegjeshme per manaxhimin e planit SPCC dhe lidhjet me Autoritetet kompetente per ngjarjet e nivelit 3.

## **VI. Per monitorimin e vazhdueshem te ndotjeve**

Pronari ose administratori detyrohet te njoftoje rregullisht Axxhensine Rajonale te Mjedisit per cdo eventualitet dhe problem qe paraqet rrezik per ndotje te mundeshme te ambientit.

Pronari ose administratori detyrohet te veje ne dijeni Axxhensine Rajonale te Mjedisit per cdo ndryshim apo shtesa te aktivitetit qe mund te kene ndikime ne mjedis.

Monitorimi i ndotjeve dhe efekteve te ketij aktiviteti do te realizohet nga struktura te specializuara dhe te dhenat do te raportohen prane Axxhensise Rajonale te Mjedisit ne perputhje me detyrimet qe rjedhin nga ligjet dhe rregullotet ne fuqi. Pronari dhe administratori eshte i detyruar te krijojte kushtet e nevojshme per monitorimin e sakte dhe te vazhdueshem.

Pronari detyrohet te zbatoje te gjitha detyrimet qe rjedhin nga ligji Nr 9010 date 13.02.2003 "Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta", Ligjit Nr 9115 date 27.07.2003 " Per trajtimin mjedisor te ujrave te ndotura", Ligjit nr 10 431, datë 09.06.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit" si dhe gjithë legjislacionin shqiptar ne lidhje me mjedisin

## **VII. Plani i Veprimit Mjedisor**

Administratori duhet te hartojte planin e veprimit mjedisor i cili duhet te permbaje:

- Rolet e qarta dhe pergjegjesite per nje menaxhim mjedisor.
- Planin financiar per menaxhimin e ambientit dhe permiresimet e kerkuara.
- Planifikim te monitorimit te performances ambientale
- Nxjerjen e objektivave te performances ambientale per te aplikuar praktikat me te mira.

- Program te qarte per realizimin e objektivave.

## **VIII. Plani i emergjences**

Qellimi i hartimit te ketij plani eshte te pergatise nje pergjigje te shpejte dhe te sigurte ndaj cdo aksidenti i cili si rezultat i derdhjes se naftes ne det ose toke, mund te shkaktoje deme serioze mjedisore (demitim te gjallesave) dhe rezik per jeten e njerezve.

Plani siguron teknika dhe udhezime per aritjen e nje reagimi efektiv dhe te koordinuar ndaj nje incidenti shkarkimi.

Objektivat specific te planit jane:

Minimizimi i efekteve të mundshme si pasojë e një derdhjeje në det dhe toke

Te krijoje ekipet e reagimit te emergjences

Te percaktoje rolin dhe pergjegjsite e anetareve te ekipit

Te percaktoje procedurat qe duhet te ndiqen per njoftimet, aktivizimin, mobilizimin ne rast te nje shkarkimi

Te percaktoje linjat dhe pergjegjesite gjate operacioneve te reagimit

Te siguroje perpuethshmerine me Politiken Ambientale te Kompanise

Te siguroje perputhshmerine me politikat dhe regullat nderkombetare, kombetare dhe locale per mbrojtjen e mjedisit.

## **IX. Menaxhimi i Incidenteve**

Një Plan për Menaxhimin e Incidenteve (PMI) ndërtohet si një kuadër për menaxhimin e krizave dhe emergjencave, dhe duhet të integrohet brenda projektit në të gjitha fazat.

Qëllimi i planit është të identifikojë pajisjet, procedurat, trajnimet dhe personelin e nevojshëm për të mbrojtur fuqinë punëtore, klientët, publikun, mjedisin dhe reputacionin e shoqërisë në rast të një incidenti.

Objektivat e përgjithshëm të PMI, sipas prioriteteve, janë:

- Mbrojtja e njerëzve (punonjësit, kontraktorët, furnizuesit, klientët dhe komunitetet);
- Mbrojtja e mjedisit (ajri, uji, derdhjet, dhe zonat e ndikueshme);
- Mbrojtja e pasurisë (shoqëria B-Jera, partnerët e shoqërisë, kontraktorët, komunitetet, objektet dhe zyrat e palëve të treta);
- Mbrojtja e interesave të biznesit (furnizimi, prodhimi dhe reputacioni).

Çdo objekt do të ketë një PMI. Të gjithë kontraktorët do të kenë një PMI të përcaktuar qartësisht, i cili do të përfshijë nënkontraktorët. Dokumente ndërmjetëse do të përcaktojnë marrëdhëniet, rolet dhe përgjegjësitë e ndërsjellta. Do të theksohen mangësitë dhe do të kryhet një vlerësim rreziku për të kuptuar gjithë çështjet e mundshme dhe shkallën e rëndësisë së tyre.

Në rast të një incidenti do të aktivizohet një alarm. Nevojat, përmasat, mundësia për përshkallëzim dhe niveli i mbështetjes që kërkohet, diktojnë masën dhe nivelin se cila njësi për menaxhimin e incidentit do të aktivizohet, dhe nëse do të njoftohet apo jo njësi për incidentet që ndodhet një nivel më lartë në organizatë.

Nëse ndodh që derdhjet të sjellin si pasojë gjermim të dheut, dhe zbulim të artefakteve arkeologjike, atëherë duhet të aplikohet procedura e gjetjeve rastësore. Për këtë arsye do të ishte me vlerë një përfshirje e procedurave të gjetjeve rastësore arkeologjike brenda procedurave të pastrimit të derdhjeve në mjedis.

Plani për menaxhimin e incidentit duhet të garantojë që janë përcaktuar qartësisht procedurat e reagimit në raste të emetimeve të paplanifikuara atmosferike që mund të paraqisnin rrezik për shëndetin e njerëzve.

Të gjitha incidentet do të dokumentohen në një Regjistër të menaxhimit të incidenteve (RMI), i cili ruhet në përputhje me procedurat e shoqërisë “Adriatik Petroleum PTE” Ltd,

## **X. Perfundime**

Studimi i paraqitur nga shoqëria B-Jera sha lidhur me projektin e ndertimit të një terminali për depozitimin e karburanteve në zonën e Portoromanos, është me impakte minimale nga pikpamja mjedisore pasi kontaktet me ambjentet në toke janë të kufizuara dhe mbrojtura mirë nga pikpamja teknologjike.

Mjedisi në të cilin vendoset ky projekt nuk paraqitet me diversitet të ndjeshëm nga pikpamja e ekosistemeve madje ai ka qenë i dominuar nga ndotjet fizike dhe kimike të trashëguara nga e kaluara dhe e dominuar nga shkarkimet aktuale të hidrovorit të ish kenetes së Durresit.

Referuar analizës komplekse të bëra në këtë studim të Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis të projektit **per ndertimin dhe funksionimin e terminalit për depozitimin e karburanteve në Portoromano, Durres**, konkludojmë se ky aktivitet nuk krijon impakte të cilat janë në papajtueshmeri me gjeomjedisin si në aspektin ekologjik po ashtu dhe atë social.

Ky investim do të sjell jo vetëm progres teknologjik por edhe social për banorët e komunitetit përreth në aspektin e punësimit dhe bashkëveprimit me këto komunitete dhe pushtetin vendor. Nga pikpamja e politikave realizimi i këtij projekti është në përputhje të



plote me fushen e veprimtarive qe ka parashikuar dhe miratuar shteti shqiptar per parkun Energjetik dhe Industrial ne zonen e Portoromanos Durres.

Instalimi i ketij sistemi depozitash per karburante, ne kete zone do te bej te mundur perpunimin e kapaciteteve te medha, duke e bere kete terminal partner rajonal ne fushen e karburanteve si dhe operator aktiv ne kuadrin e koridorit te trete.

Nje element qe vlen te permendet ne kuadrin e ketij projekti eshte ritja e koeficientit te sigurise operationale nepermjet stakimit automatik te sistemeve ne cdo rast qe prishen parametrat navigacional dhe krijohet situat e emergjence .

Parandalimi i ngjarjeve te jashtezakonshme dhe evitimi i ndotjeve operationale apo aksidentale ne kete projekt shoqerohet me sensor dhe aksesore nga me efikaset, sikurse eshte stakimi automatik dhe funksionimi i rjetave ekologjike per izolimin dhe pastrimin e ndotjeve ne sipërfaqet ujore dhe tokesore. Teresia e faktoreve qe kontrollojne dhe kontribojne ne nevojen dhe efikasitetin e ketij projekti, jane nje suport bindes per pranueshmerine e realizimit te tij.

Duke studiuar projektin, planimetrit, rrethanat mjedisore qe lidhen me aktivitetin, kushtet e pergjitheshme te funksionimit si dhe masat qe do te meren per evitimin e ndotjeve potenciale, mendojme qe ndertimi dhe funksionimi i Terminalit per Depozitimin e Karburanteve, ne Portoromano, Durres, nuk sjell pasoja te dukshme ne mjedis qe mund te pengojne zhvillimin e ketij aktiviteti.

**Green Hours” sh.p.k.**

**Administratori**

**Bardhyl Qilimi**

**Tirane, me 18.08.2017**

**Eksperti**

**Denis Harasani, Ing Miltiadh Mata**